



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
BYROJA

V E N D I M

Nr. 19 , datë 27.9.2018

“PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË DETAJUAR PER SJELLJEN NË KUVEND”

Në mbështetje të nenit 32 të Kodit të Sjelljes të Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, Byroja e Kuvendit, në mbledhjen e saj të datës 27.9.2018, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Udhëzuesit të Detajuar për Sjelljen në Kuvend” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI

**UDHËZUES I DETAJUAR I KODIT TË SJELLJES SË
DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Miraturar me vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 19, datë 27.9.2018

HYRJE

Ky Udhëzues është hartuar në mbështetje të nenit 32 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61/2018 “Kodi i Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë”.

Zbatimi i Kushtetutës, Rregullores së Kuvendit ose akteve ligjore në fuqi, si dhe respektimi i parimeve dhe rregullave të Kodit të Sjelljes dhe të etikës profesionale nga deputeti rrit besueshmërinë e publikut tek institucioni i Kuvendit në përgjithësi dhe te klasa politike në veçanti.

Udhëzuesi synon të plotësojë me interpretim, shpjegim ose me rregulla procedurale, Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Përmbledhja tërësore e vlerave dhe parimeve të Kodit të Sjelljes duhet të udhëheqë deputetët në sjelljen dhe veprimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve dhe angazhimeve si përfaqësues i zgjedhësve dhe funksionit si ligjvënës.

Respektimi i Kodit të Sjelljes, si dhe referimi korrekt në trajtimin e çështjeve në këtë Udhëzues dëshmon pajtimin e deputetit me Kodin e Sjelljes dhe në përgjithësi raportin e tij me ligjin dhe rendin juridik.

1

Keqpërdorimi i figurës së deputetit

Udhëzime për zbatimin e nenit 2 të Kodit të Sjelljes

Funksioni publik si përfaqësues i zgjedhësve dhe organit ligjvënës sjell si pasojë një dimension të ndryshëm të jetës private dhe privatësisë për deputetin nga ai i një shtetasi të zakonshëm.

Për të vlerësuar kufijtë e sjelljes në jetën private, Kodi ka vlerësuar se konsiderohet sjellje negative që ndikon në jetën publike, ajo formë sjellje, pasojat e të cilës:

- reflektohen përveçse në besimin publik të vetë deputetit; edhe
- në cenimin e imazhit të institucionit të Kuvendit.

Byroja e Kuvendit, si autoritet përgjegjës për zbatimin e këtij Kodi Sjelljeje, mund të marrë në shqyrtim dhe analizë raste të veçanta të sjelljes së deputetit të lidhura me:

- a) keqpërdorimin e figurës së deputetit si përfaqësues i Kuvendit;
- b) ofrimin e modeleve të gabuara; ose
- c) nxitje të formave joetike ose të dënueshme për zgjedhësit.

Çdo grup parlamentar, organizatë jofitimprurëse ose subjekte të tjera (duke bashkëlidhur përshkrimin e rastit dhe provat dokumentare ose filmike nëse ka), mund të referojnë në Kuvend rastin për të cilin ata besojnë se sjellja e deputetit mund të klasifikohet si sjellje negative që tejkalon aspektet e jetës private në atë masë që ndikon në uljen e besimit publik ndaj institucionit të Kuvendit.¹

¹ Si të tilla mund të trajtohen sjelljet tipike të deputetëve në lidhje me sjelljen në mjedise publike, shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor (ecje me shpejtësi tej normave të lejuara, parkim në trotuare, parkim në vende ku ndalohet parkimi etj.), ose pirja e duhanit në vende ku ligji e parashikon shprehimisht ndalimin.

Byroja e Kuvendit, gjatë shqyrtimit të çështjes, arsyeton në lidhje me masën e cenimit të besimit publik të deputetit, si dhe nëse masa e cenimit të besimit për shkak të sjelljes negative të deputetit, ka prekur imazhin dhe besimin e publikut në raport me Kuvendin.

Byroja, në varësi nga rasti, nga masa e cenimit të imazhit të institucionit dhe nga të dhëna të regjistrit të masave disiplinore, për ekzistencën ose jo të masave të tjera në të kaluarën, vendos për marrjen ose jo të masës disiplinore dhe për llojin e masës, në përputhje me nenin 63 të Rregullores së Kuvendit.

Arsyetimi i rastit të posaçëm, kur ai do të konsiderohet nga Byroja e Kuvendit si veprim ose sjellje negative që cenon në mënyrë të dukshme dhe haptazi besimin publik në institucionin e Kuvendit, bëhet pjesë e këtij udhëzimi dhe zbatohet njësoj ose për analogji në të ardhmen.

2

Zbatimi i parimeve të etikës

Udhëzime për zbatimin e neneve 3, 4 dhe 5 të Kodit të Sjelljes

Deputeti mund dhe duhet të konsiderojë që çdo mangësi ose shkelje në sjelljen profesionale ose në jetën personale mund të ndikojë në vlerësimin mbi integritetin personal dhe vlefshmërinë e punës së tij dhe, si pasojë, mund të ngrejë dyshime rreth besueshmërisë së gjithë procesit parlamentar.

Zbatimi dhe respektimi në bllok i rregullave të Kodit të Sjelljes dëshmon integritetin personal të deputetit.

Integriteti kërkon që deputeti:

- a) të reflektojë standarde të larta profesionale e personale në ushtrimin e funksioneve të tij, për të siguruar funksionimin sa më transparent, të ndershëm, të drejtë dhe të përgjegjshëm të institucionit të Kuvendit;
- b) të garantojë mbrojtjen e interesit publik në gjithë aktivitetin e tij, duke shmangur çdo sjellje që mund të komprometojë integritetin dhe besueshmërinë e publikut;
- c) të shprehë në mënyrë besnike të vërtetën, pa frikë dhe pa u ndikuar nga pikëpamjet e bindjet politike, sociale, fetare ose ekonomike të personave që takojnë gjatë detyrës;
- ç) të shmangë sjellje të paqarta dhe të dyshimta, çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, orientimit seksual, kombësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimi të bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose për çdo shkak tjetër;

d) të ruajë të pastër figurën e tyre morale dhe të shmangë sjellje ose veprime, të cilat cenojnë autoritetin dhe imazhin e tij para opinionit publik.

Njësia matëse e integritetit është raporti i perceptimit publik midis mënyrës së sjelljes dhe veprimit, nga njëra anë, dhe asaj që është e ligjshme dhe e drejtë, nga ana tjetër.

3

Shpërdorimi i të drejtave procedurale

Udhëzime për zbatimin e nenit 3 të Kodit të Sjelljes

Deputeti, gjatë ushtrimit të funksionit, orientohet drejt përdorimit të saktë dhe në përputhje me dispozitat në fuqi të të drejtave që i jepen nga ligji, dispozitat e Rregullores së Kuvendit dhe të dispozitave të Kodit të Sjelljes.

Të drejtat procedurale që i ofrohen deputetit nga Rregullorja e Kuvendit për t'u përdorur dhe referuar gjatë zhvillimit të procedurave parlamentare, si në mbledhjet e komisioneve, ashtu edhe në seancat parlamentare ose gjatë mbledhjeve të organeve të Kuvendit, si e drejta për replikë, nuk duhet të keqpërdoren në funksion të qëllimeve të tjera që nuk kanë lidhje me vijimin normal të procesit parlamentar.

Keqpërdorimi i së drejtës për të kërkuar fjalën për procedurë ose për replikë, gjatë zhvillimit të seancave të komisioneve dhe sidomos të seancave plenare, janë shpërdorime të besimit dhe sjellje, të cilat nuk justifikohen se udhëhiqen nga interesi publik.

Në rastet kur fjala kërkohet për procedurë, Rregullorja e Kuvendit ka parashikuar të drejtën për të marrë fjalën menjëherë, pavarësisht nga çështja në shqyrtim ose faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i çështjes. Shpërdorimi i kësaj së drejte, duke përfituar nga e drejta e fjalës për procedurë dhe më pas për të trajtuar çështje të ndryshme nga ato procedurale, ka si pasojë ndërprerjen e çdo diskutimi tjetër dhe si rrjedhim pengon zhvillimin normal të veprimtarisë parlamentare. Pengimi i veprimtarisë parlamentare nuk është veprim në interes të popullit dhe nuk mund të konsiderohet në interes të publikut.

Deputeti duhet të vetëorientohet dhe t'i referohet së drejtës për të ndërhyrë për çështje të procedurës vetëm duke referuar:

- pikën e rregullore, e cila pretendon se po shkelet;
- ndyshimin që propozon të bëhet në rendin e ditës së miratuar;
- nevojën për ndërprerje ose shtyrje të seancës ose diskutimeve për çështje të tilla si prezenca në sallë ose kuorumi; si dhe
- në çështje lidhur me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerje të votimit.

Kur deputeti ka marrë fjalën sipas kërkesës së tij për procedurë dhe drejtuesi i seancës konstaton se deputeti nuk përqendrohet në trajtimin e çështjes, në përputhje me dispozitat e nenit 49, të Rregullores së Kuvendit, atëherë drejtuesi i seancës i referohet zbatimit të dispozitave të kreut IX të Rregullores së Kuvendit, që parashikojnë procedurat e masave disiplinore.

Deputeti duhet t'i referohet së drejtës së replikës vetëm në ato raste kur ndaj tij janë përdorur fjalë të padenja ose të pahijshme, ose janë bërë diskutime që kanë shtrembëruar thelbin e fjalës së tij.

Kodi i Sjelljes parashikon në përgjithësi ndalimin e përdorimit nga deputetët të fjalëve të padenja ose të pahijshme, ndaj nuk mund të ketë kërkesë për replikë për arsye të përdorimit të fjalëve të padenja ose të pahijshme nëse:

- nuk konstatohet gjatë replikës përdorimi i tyre; dhe
- replika nuk shoqërohet me kërkesën për fillim të procedurave disiplinore.

Në rast se drejtuesi i mbledhjes së komisionit parlamentar ose drejtuesi i seancës plenare konstaton keqpërdorimin e të drejtave procedurale, i tërheq vëmendjen deputetit dhe e fton që të kthehet në kufijtë proceduralë të përdorimit të së drejtës.

Nëse edhe pas tërheqjes së vëmendjes shkelja vazhdon, atëherë sipas rastit:

- drejtuesi i seancës së komisionit parlamentar vendos për përcjelljen e rastit për shqyrtim në Byronë e Kuvendit; ose

- drejtuesi i seancës plenare vijon me masën e vërejtjes dhe në varësi nga vijimi i sjelljes së deputetit, merr vendim për përjashtimin nga seanca plenare dhe, sipas rastit, i prezanton Byrosë së Kuvendit propozimin për masa disiplinore më të rënda, bazuar në parashikimet e Rregullores së Kuvendit.

4

Kufijtë e lejuar të shprehjes së mendimit politik dhe personal *Udhëzime për zbatimin e nenit 6 të Kodit të Sjelljes*

Në raste të përdorimit të gjuhës së pahijshme, fyese ose kërcënuese, si dhe të asaj që nxit urrejtje ose diskriminim, zbatohen dispozitat e Kodit të Sjelljes dhe në këto raste drejtuesi i seancës plenare dhe Byroja e Kuvendit u referohen masave disiplinore për shkelje të rënda të Rregullores së Kuvendit, nenit 65 të saj.

Në çdo rast duhet të mbahet në konsideratë që rregulli i përgjithshëm për ndalimin e përdorimit të gjuhës së pahijshme, fyese ose kërcënuese, si dhe të asaj që nxit urrejtje ose diskriminim, nuk nënkupton ndalimin e lirisë së të shprehurit të pikëpamjeve, qëndrimeve personale ose politike dhe që përbëjnë pozicione të qarta konservatore, liberale ose të tjera, për sa kohë që formulimet:

- janë në përputhje me rendin kushtetues;
- nuk kanë përmbajtje gjyquese ose denigruese;
- nuk cenojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve dhe si të tilla nuk mund të trajtohen si qëndrime diskriminuese; dhe
- nuk synojnë nisma që cenojnë liri ose të drejta.

5

Ndalimi i pengimit të pjesëmarrjes në votim të kolegëve Udhëzime për zbatimin e nenit 7 të Kodit të Sjelljes

Pjesëmarrja në votim dhe shprehja e vullnetit politik ose personal nëpërmjet votës konsiderohet ushtrim i funksionit të deputetit. Deputeti ushtron të drejtën e tij absolute për të votuar personalisht në komisione ose në seancë plenare.

Deputeti nuk mund të pengojë votimin e deputetëve të tjerë duke përdorur presionin ose dhunën. Çdo rast i tillë konsiderohet dhe duhet të trajtohet si pengim i një zyrtari për të ushtruar detyrën e vet.

Deputeti, për votimin nëpërmjet mjeteve elektronike, është i pajisur me kartën e votimit. Karta e votimit është vetjake dhe nuk mund të përdoret nga deputetë të tjerë.

Përpara fillimit të seancës plenare, shërbimi përgjegjës kontrollon funksionimin e sistemit elektronik të votimit, si dhe verifikon praninë e kartës së votimit për çdo deputet.

Gjatë praktikës parlamentare të votimit mund të konstatohet:

- votim i një deputeti duke përdorur kartën e votimit të një deputeti tjetër; ose
- votim për llogari të një deputeti tjetër.

Në respektim të rregullit për ndalimin e votimit për të tretë, në rast se Sekretariati Teknik konstaton votim për të tretë, atëherë vë në dijeni drejtuesin e seancës plenare në lidhje me këtë fakt. Drejtuesi i seancës thërret menjëherë në konsultë si deputetin që ka votuar për një tjetër, ashtu edhe deputetin, i cili në dukje ka deleguar të drejtën e votës.

Nëse nga konsulta rezulton se deputeti gabimisht ka përdorur për votimin e vet kartën e një deputeti tjetër, atëherë ndaj tij jepet masa e vërejtjes nga drejtuesi i seancës dhe masa nuk ka efekt mbi vlefshmërinë e votës.

Nëse nga konsulta rezulton se deputeti ka deleguar votën te një deputet tjetër, atëherë drejtuesi i asaj seance, gjatë të cilës është konstatuar delegimi i votës, ia paraqet Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet. Ky i fundit shqyrton rastin dhe nëse konstaton parregullsi, orienton drejtuesin e seancës për mënyrën e vijimit të procedurës. Nëse ka shkelje, që përbën masë disiplinore, drejtuesi i seancës, referon në Byronë e Kuvendit rastin. Byroja fillon procedurat disiplinore për shkelje të Rregullores së Kuvendit, për të dy deputetët. Vota e hedhur për një deputet tjetër në këtë rast konsiderohet e pavlefshme.

Nëse nga konsulta nuk rezulton që të jetë deleguar vota, por deputeti thjesht dhe me vullnetin e tij ka votuar për një deputet tjetër, atëherë procedura disiplinore për shkelje të Rregullores fillon vetëm për të. Vendimi i Byrosë publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

Veshja zyrtare*Udhëzime për zbatimin e neni 8 të Kodit të Sjelljes²*

Deputetët ftohen të ruajnë një raport të drejtë midis funksionit politik dhe përfaqësues, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, përshtatjes së stilit të veshjes me këtë funksion.

Veshja e deputetit gjatë seancave të komisioneve, seancës plenare, pjesëmarrjes në mbledhje të organeve të Kuvendit ose takimeve të organizuara në funksion të qenies anëtar i Kuvendit duhet:

- të jetë e përshtatur me funksionin;
- të konsiderojë mjedisin e veprimtarive parlamentare si mjedis pune; dhe
- të konsiderohet si përcjellëse e normave dhe parimeve etike të atij që e mban.

Pamja, kontaktet për shkak të punës, veprimet dhe përshtypja e përgjithshme që deputetët japin në punë, janë faktorë të rëndësishëm edhe për ruajtjen e reputacionit të institucionit të Kuvendit, i cili duhet të jetë në përputhje me tendencat mbizotëruese në nivele institucionesh të ngjashme. Të gjithë deputetët, pavarësisht gjinisë, duhet të jenë të vetëdijshëm që të kenë një pamje të jashtme zyrtare, profesionale dhe të përshtatshme.

Është përgjegjësi e drejtuesit të seancës, ose në përgjithësi të drejtuesit të mbledhjes ose ftuesit të një takimi, që të monitorojë respektimin dhe të tërheqë vëmendjen për respektimin e kodit të veshjes nga deputetët. Në rast se drejtuesi i seancës së komisionit, seancës plenare ose i organit të Kuvendit konstaton mosrespektim të Regullores, fton deputetin të largohet dhe të përshtatë veshjen.

² Për t'i ardhur në ndihmë dhe për t'u orientuar drejtë, më poshtë është:

Modeli i përdorur në sistemin bankar:

Për meshkujt: këmishë me mëngë të gjata; pantallona të gjata serioze/jo të rastit/ të shkujdesura (casual); rekomandohet të vendosin një kravatë, e cila duhet të jetë e lidhur mirë; këpucë serioze; të shmangin aksesorë dhe stampa të dukshme; të jenë gjithmonë të rruar ose në çdo rast me mjekër dhe flokë të kurrar e të rregullt.

Për femrat: veshje zyrtare dhe të shmangin fundet e shkurtra, dekolletë, veshjet pa mëngë, materialet sportive ose ekstravagante (xhinse, lëkura) ose ngjyrat e forta; këpucë zyrtare të mbyllura para dhe të shmangin takat e larta (mbi 7 cm), platformat, si dhe ngjyrat e forta; nëse duhet të përdorin bixhuteri, ato duhet të jenë fine dhe elegante; të shmangin tualetin e tepruar (të përdorin ngjyra të lehta) dhe parfumin e tepruar; të shmangin aksesorët e mëdhenj dhe me ngjyrë të fortë; të shmangin lyerjen e thonjve, prerjen e flokëve dhe përdorimin e ngjyrave, në mënyrë ekstravagante.

Përshkrimi i kodit të veshjes së modelit të Kombeve të Bashkuara.

Për meshkujt: Nga ata pritet një kollare dhe një këmishë serioze, zyrtare. Xhaketat janë të rekomandueshme, por nuk kërkohen. Pantallonat duhet të jene zyrtare dhe të vishen me këmishë. Xhinset ose pantallonat e shkurtra nuk janë të duhurat dhe janë të papranueshme. Këpucët duhet të jenë zyrtare dhe të përshtatshme për eventin.

Për femrat: Një bluzë e këndshme do të ishte ajo e duhura dhe e përshtatshme, por dekolteja nuk duhet të jetë e dukshme. Për ta bërë veshjen tuaj të duket akoma më mirë, xhaketa do të ishte perfekt. Të gjitha femrat duhet të veshin pantallona, gjatësia e të cilave të jetë poshtë gjurit. Nëse vishet fustan, ai duhet të jetë serioz, zyrtar, i përshtatshëm për eventin dhe jo fustan mbrëmje.

Më poshtë jepen disa rregulla të veçanta për fustanet:

- Dekolteja: - Fustani nuk duhet të jetë i hapur sa të arrijë skajet e shpatullave.
- Gjatësia: - Gjatësia e fustanit duhet të jetë deri poshtë gjurit.
- Të ngushta - duhet mbajtur parasysh të mos jetë i ngushtë, me përjashtim të pjesës së belit.
- I njëjti rregull aplikohet dhe për fundet. Nëse femrat dëshirojnë të veshin funde, gjatësia e tyre duhet të jetë deri poshtë gjurit. Po ashtu kërkohen dhe këpucë serioze. Fundet sportive dhe shapkat e plazhit nuk lejohen.
- Rregulli i përgjithshëm: JO dekolte të tepruar, JO shpatulla jashtë, JO gjunjë të zbuluar!

Konstatimi i gjendjes së uljes së ndjeshme të ekuilibrit fizik dhe/ose mendor
Udhëzime për zbatimin e nenit 8 të Kodit të Sjelljes

Paraqitja e deputetit në kushtet e një gjendjeje në dukje me mungesë të kontrollit fizik ose mendor ose të uljes së ndjeshme të ekuilibrit fizik dhe/ose mendor mund të përbëjë shkak për verifikim të arsyeve.

Verifikimi bëhet në ato raste kur ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se sjellja atipike mund të jetë shkaktuar nga konsumimi i alkoolit dhe/ose substancave narkotike ose psikotrope. Për verifikimin e gjendjes së deputetit, nëse konstatimi bëhet gjatë zhvillimit të seancave të mbledhjeve të komisioneve ose të seancës plenare, drejtuesi i seancës ndërpret seancën për jo më pak se 10 minuta dhe jo më shumë se 30 minuta.

Drejtuesi i seancës, në prezencë të drejtuesit të grupimit parlamentar, të cilit i përket deputeti, fton deputetin në konsultë, gjatë së cilës verifikon gjendjen. Nëse deputeti nuk është pjesë e ndonjë grupi parlamentar, në konsultë ftohen të marrin pjesë drejtuesit e të gjitha grupeve parlamentare. Nëse drejtuesi i seancës konstaton se sjellja atipike mund të jetë shkaktuar nga konsumimi i alkoolit dhe/ose substancave narkotike ose psikotrope, këshillon deputetin që të mos hyjë në seancë dhe të largohet nga mjediset e Kuvendit.

Nëse deputeti pranon, ai shoqërohet deri jashtë mjediseve nga drejtuesi i grupit parlamentar të cilit i përket ose nga shërbimi i sigurisë në Kuvend.

Nëse deputeti nuk është pjesë e ndonjë grupi parlamentar, shoqërimi i tij bëhet nga drejtuesi i grupit parlamentar më të vogël, nga drejtuesi i një grupi parlamentar të përzier ose nga shërbimi i sigurisë në Kuvend.

Nëse deputeti nuk pranon të largohet dhe rihyn në mjediset ku zhvillohet seanca, atëherë:

- Nëse ngjarja ndodh gjatë mbledhjes së një komisioni parlamentar, drejtuesi i seancës ndërpret mbledhjen dhe i përcjell Byrosë së Kuvendit kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore për deputetin. Byroja e merr në shqyrtim dhe vendos në përputhje me parashikimet në Rregulloren e Kuvendit.

- Nëse ngjarja ndodh gjatë një seance plenare, drejtuesi i seancës, menjëherë pas rihapjes së seancës, vendos përjashtimin e deputetit nga seanca dhe, nëse e gjykon të arsyeshme, fillon procedurat për marrjen e masës disiplinore ndaj tij.

Nuk është e nevojshme të kërkohet verifikim i gjendjes, në ato raste kur sjellja në dukje atipike ka lidhje me një gjendje shëndetësore të njohur, që prek aftësitë fizike, por nuk cenon aftësitë mendore të deputetit.

Raportet e deputetëve me stafin e shërbimeve të Kuvendit
Udhëzime për zbatimin e nenit 9 të Kodit të Sjelljes

Deputeti ka të drejtë që gjatë veprimtarisë së tij të asistohet nga shërbimet e Kuvendit dhe stafi tjetër i angazhuar në punimet parlamentare.

Kryetarët e komisioneve parlamentare nuk përfshihen në kufizimet e përshkruara në këtë pikë, pasi organizimi dhe funksionimi i komisioneve parlamentare konsiderohen si procedura të shqyrtimit parlamentar që paraprihen nga një procedurë dokumentare e inicuar në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Deputeti, sa herë që ka nevojë për asistencë ose këshillim, duhet t'i referohet, nga njëra anë, funksionit përkatës që nëpunësi i Kuvendit mbulon dhe, në çdo rast, përshkrimin të punës së tij. Gjithashtu, kërkesa për asistencë ose këshillim duhet të jetë e lidhur me veprimtarinë përkatëse

në të cilën merr pjesë deputeti (seanca komisione, seanca plenare, organe të Kuvendit) dhe për të cilën në rregulloren e funksionimit është parashikuar përfshirja e stafit të Kuvendit.

Deputeti, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, ka të drejtë të kërkojë të dhëna statistikore të lidhura me veprimtaritë parlamentare.

Çdo përdorim i stafit të Kuvendit, në lidhje me procedura të shqyrtimit parlamentar, duhet të paraprihet nga një procedurë dokumentare e inicuar në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Deputeti nuk mund të kërkojë nga stafi teknik i Kuvendit përgatitje fjalimesh ose raportesh, të cilat i shërbejnë angazhimit personal politik të tij.

Çdo porosi ose kërkesë që ka për qëllim hartimin e dokumenteve ose raportimeve që nuk kanë lidhje me një procedurë të nisur parlamentare, por që në çdo rast përfshihet në veprimtarinë e zakonshme ose të jashtëzakonshme të Kuvendit, duhet të dërgohet në fillim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Kërkesa mund të ndjekë rrugën elektronike të dërgimit dhe, në raste urgjente, mund të dërgohet edhe drejtpërdrejt te nëpunësi që ngarkohet të merret me plotësimin e kërkesës, por në këtë rast ajo duhet t'i dërgohet për dijeni edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

Nëse kërkesa bëhet nga deputeti që ka edhe funksionin e Zëvendëskryetarit të Kuvendit, informacioni i vihet në dispozicion njëkohësisht edhe zëvendëskryetarëve të tjerë.

Kërkesa, pavarësisht mënyrës se si përcillet, nëpërmjet protokollit ose postës elektronike, duhet të përmbajë qëllimin për të cilin kërkohet dokumenti, raporti, statistika ose në përgjithësi materiali që kërkohet të përgatitet.

Çdo kërkesë sa më sipër, e për të cilën nuk janë respektuar rregullat e përshkruara në këtë pikë të udhëzuesit, nuk mund të sjellë pasoja për stafin e Kuvendit.

Rregulli i mësipërm për të vënë në dijeni në çdo rast Sekretarin e Përgjithshëm nuk përfshin kabinetin e Kryetarit të Kuvendit, që konsiderohet se ka marrë porosinë drejtpërdrejt nga Kryetari i Kuvendit.

9

Ndalimi i përdorimit të pasurisë dhe burimeve materiale të Kuvendit për nevoja vetjake

Udhëzime për zbatimin e nenit 9 të Kodit të Sjelljes

Deputeti ka të drejtë që gjatë veprimtarisë së tij të përdorë dhe të shfrytëzojë mjediset e Kuvendit dhe burimet materiale të institucionit. Përdorimi duhet të jetë i lidhur me funksionin dhe në shërbim të ushtrimit të detyrës.

Nëse konstatohen raste të dëmtimit për përdorim për nevoja vetjake të pasurisë dhe burimeve materiale (mjete, pajisje, kanceleri dhe të tjera të ngjashme me to), Byroja e Kuvendit vendos shlyerjen e vlerës nga të ardhurat e deputetit.

10

Këshillimi i deputetëve të rinj

Udhëzime për zbatimin e nenit 12 të Kodit të Sjelljes

Tre muajt e parë të fillimit të çdo legjislature, administrata e Kuvendit njofton dhe organizon takime të hapura me deputetët e rinj.

Programi i kësaj veprimtarie, që ka për qëllim orientimin dhe këshillimin paraprak të deputetëve të rinj, përmban të paktën këto çështje:

- prezantim i përgjithshëm i Rregullores së Kuvendit;
- prezantim i Kodit të Sjelljes dhe Udhëzuesit të Detajuar për Sjelljen në Kuvend;
- prezantim përmbledhës i të drejtave dhe detyrimeve të deputetit;

- prezantim i organizimit të shërbimeve të Kuvendit në funksion të veprimtarisë parlamentare.

Programi i dërgohet çdo deputeti të ri dhe ai përmban orën dhe datat e organizimit të takimeve, si dhe personat që do të prezantojnë çështjet.

Deputetë të caktuar që mund të kenë nevojë për tema të veçanta, duhet t'i paraqesin kërkesë Sekretarit të Përgjithëm të Kuvendit dhe ai, brenda dy ditëve nga marrja e kërkesës, nëse nuk plotëson dot vetë kërkesën, cakton një nëpunës të Kuvendit që të asistojë deputetin.

Pavarësisht listës së deputetëve, të cilët janë ftuar të marrin pjesë, takimet informuese janë të hapura për çdo deputet që dëshiron të marrë pjesë.

11

Deklarimi rast pas rasti i gjendjes së konfliktit të interesit

Udhëzime për zbatimin e nenit 13 të Kodit të Sjelljes

Rastet e konfliktit të interesit për deputetin, në zbatim të legjislacionit shqiptar dhe dispozitave që rregullojnë statusin e deputetit, mund të konsistojnë në:

- gjendje të konfliktit të interesit të vazhdueshëm; ose
- konflikt i interesit rast pas rasti.

Konflikti i interesit mund të ketë lidhje jo vetëm me proces ligjvënës, por edhe me çdo çështje që lidhet me funksionimin e veprimtarisë parlamentare.

Për vlerësimin e gjendjeve të konfliktit të interesit mbahet parasysh legjislacioni që rregullon statusin e deputetit dhe dispozitat e Kodit të Sjelljes në ato raste që përshkruajnë ndalimet dhe papajtueshmëritë me funksionin e deputetit.

Për deputetin përbën situatë konfliktit i interesit, përveç trajtimit të përgjithshëm të përshkruar në dispozitat që rregullojnë konfliktin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike, edhe çdo situatë personale e deputetit, në të cilën shprehja e vullnetit nëpërmjet votës mund të ndikohet nga gjendje, marrëdhënie ose interesa që nuk lidhen me ushtrimin e funksionit të deputetit ose i ndonjë funksioni tjetër publik në të kaluarën, ose në momentin e votimit.

Në rastin kur konflikti i interesit është i lidhur me çështjen ose projektligjin në shqyrtim nga komisionet parlamentare, organet parlamentare ose seanca plenare, deklarimi i konfliktit duhet të bëhet menjëherë në seancën e parë që mbledhet për shqyrtimin e çështjes, ose në çdo rast në seancën më të parë në të cilën deputeti është prezent.

Vlerësohet se gjendja e konfliktit të interesit ka efekt në heqjen e së drejtës së votës edhe në ato raste kur deputeti e deklaron votën e tij paraprakisht si pjesë e një votimi politik të grupit parlamentar të cilit i përket.

Kur deputetë të tjerë, media, ose organizata të pavarura japin informacione ose ngrenë akuza për gjendjen e konfliktit të interesit rast pas rasti për një deputet, deputeti në fillim të seancës më të parë plenare, të mbledhjes së komisionit ose organeve të tjera parlamentare, në të cilat merr pjesë, deklaron vlerësimin e tij në lidhje me gjendjen ose jo në konflikt i interesit.

Me kërkesë të të paktën një grupi parlamentar, çështja i kalon për shqyrtim Byrosë së Kuvendit, si autoriteti përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes.

Byroja e Kuvendit shqyrton çështjen brenda 48 orëve dhe pas vlerësimit të rastit vendos nëse deputeti është ose jo në kushtet e gjendjes së konfliktit të interesit.

Deklarata e interesave privatë dhe publikimi i saj
Udhëzime për zbatimin e neneve 13 dhe 14 të Kodit të Sjelljes

Lloji i informacionit që përpunohet nga Kuvendi, për efekt të publikimit në faqen zyrtare të Kuvendit dhe detyrimi për publikim i interesave privatë në një regjistër të posaçëm (sipas parashikimeve të Kodit të Sjelljes), ndjek qëllime të tjera nga ato të ndjekura nga ILDKPKI, në funksion të transparencës. Regjistri mbahet, përditësohet dhe publikohet nga Kuvendi. Ai organizohet në funksion të transparencës lidhur me kufizime, ndalime ose në përgjithësi me respektim të dispozitave të Kodit të Sjelljes e që mund të përbëjnë gjendje të konfliktit të vazhdueshëm.

Në zbatim të Kodit të Sjelljes, deputeti (përveç deklaramit dhe formularit të plotësuar për ILDKPKI-në), për qëllime të verifikimit të gjendjes së konfliktit të vazhdueshëm, plotëson dhe dorëzon në të njëjtat afate pranë Shërbimit të Trajtimit të Deputetëve edhe deklaratën e interesave privatë. Deklarata e interesave privatë duhet të organizohet që të plotësohet me:

- përshkrim të kontratës ose në përgjithësi të marrëdhënies civile, e cila ka si pasojë gjenerimin e të ardhurave për deputetin;

- emrin e individit, personit fizik ose juridik, me të cilin është lidhur kontrata, ose në përgjithësi deputeti ka pasur marrëdhënie juridiko-civile, ose të tjera që kanë pasur si pasojë gjenerimin e të ardhurave për deputetin.

Deklarata e interesave privatë nuk është e detyrueshme të plotësohet edhe me shumën e të ardhurave, numrat e llogarive bankare, adresa banesash, lokalesh shërbimi ose selish, pasi për vlerësimin e gjendjeve të konfliktit të vazhdueshëm, është i mjaftueshëm lloji i kontratës dhe emri ose emërtimi i palës në kontratë ose në marrëdhënien juridiko-civile që ka sjellë si pasojë gjenerimin e të ardhurave për deputetin.

Shërbimi i Trajtimit të Deputetëve seleksionon, midis deklaratave të deputetëve, ato deklaratave ku rezultojnë të dhëna për të ardhura të tjera, të ndryshme nga të ardhurat nga paga ose nga puna dhe veprimtaria si deputet. Këto të dhëna mblidhen dhe hidhen në regjistrin e konfliktit të interesit që publikohet në faqen e Kuvendit dhe përditësohet çdo vit, brenda dy muajve nga afati i fundit i dorëzimit të deklaratave pranë Shërbimit të Trajtimit të Deputetëve. Rregjistri duhet të përmbajë:

- emrin e deputetit;

- përshkrim të kontratës, ose në përgjithësi të marrëdhënies civile, e cila ka si pasojë gjenerimin e të ardhurave për deputetin;

- emrin e individit, personit fizik ose juridik, me të cilin është lidhur kontrata ose në përgjithësi deputeti ka pasur ose ka në vazhdim marrëdhënie juridiko-civile ose të tjera që kanë pasur si pasojë gjenerimin e të ardhurave për deputetin;

- të drejta mbi kapitalin e shoqërive tregtare të zotëruara nga bashkëshorti/bashkëjetuesi, fëmijët e rritur dhe prindërit e deputetit;

- shuma e të ardhurave, nëse deputeti jep pëlqimin.

Deklarata e konfliktit të interesit, deri në plotësimin e infrastrukturës elektronike nga ILDKPKI dhe krijimin e kushteve për publikimin e tyre nga ILDKPKI, mund të publikohet në faqen e Kuvendit me miratimin e deputetit, sipas afatit përkatës. Kur publikimi i deklaratave të konfliktit të interesit bëhet nga ILDKPKI, ato i dërgohen ILDKPKI-së, brenda dy muajve nga dorëzimi pranë Shërbimit të Trajtimit të Deputetëve dhe mbajtjes së kopjes për efekt të përpunimit të të dhënave për regjistrin e konfliktit të interesit.

Deklarimi ose konstatimi i konfliktit të interesit, përveç rasteve të parashikuara si ndalime ligjore, ka efekt në mospjesëmarrjen në votim të deputetit gjatë shqyrtimit të çështjes ose aktit. Për deklarinimin ose konstatimin e konfliktit të interesit për veprimtari të parashikuara si ndalime

ligjore, ndiqen procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi e që lidhen me pasoja në vlefshmërinë e mandatit të deputetit.

Bashkëlidhur këtij Udhëzuesi është formati i deklaratës së konfliktit të interesave.

13

Regjistri i konfliktit të interesit

Udhëzime për zbatimin e neneve 14 dhe 16 të Kodit të Sjelljes

Shërbimi i Trajtimit të Deputetëve organizon dhe përditëson regjistrin elektronik të konfliktit të interesit.

Regjistri elektronik përmban si të dhënat që rezultojnë nga formulari i interesave privatë, ashtu edhe të dhëna mbi deklarata të bëra nga deputeti për gjendje të konfliktit të interesit rast pas rasti për çështje të caktuara.

Regjistri organizohet mbi bazën e listës së deputetëve dhe të paktën këto të dhëna:

1. Emrin e individit, personit fizik ose juridik me të cilin deputeti ka pasur marrëdhënie juridiko-civile kontraktuale ose çdo marrëdhënie tjetër me individë ose subjekte që ka pasur si pasojë gjenerimin e të ardhurave për deputetin dhe që përbën konflikt të vazhdueshëm.

2. Të drejta mbi kapitalin e shoqërive tregtare të zotëruara nga bashkëshorti/bashkëjetuesi, fëmijët e rritur dhe prindërit e deputetit dhe që mund të përbëjnë kufizim në veprimtari tregtare.

3. Deklarata me shkrim e deputetit në lidhje me konfliktin e interesave për çështje të caktuara të diskutuara gjatë legjislaturës, ose në çdo rast gjatë periudhës/periudhave në të cilat ai ka qenë deputet.

4. Legjislatura, ose në çdo rast, periudha gjatë së cilës personi ka qenë deputet (kur deputeti nuk ka arritur të qëndrojë deputet gjatë një legjislature të plotë).

5. Përshkrim i shkurtër i natyrës së konfliktit.

6. Vendime të Byrosë së Kuvendit për masa disiplinore të marra ndaj deputetit e të lidhura me gjendjen e konfliktit të interesit (nëse ka).

Bashkëlidhur këtij Udhëzuesi është formati i deklaratës së lidhur me konfliktin e interesave rast pas rasti.

14

Kufizime në veprimtarinë tregtare

Udhëzime për zbatimin e nenit 17 të Kodit të Sjelljes

Në zbatim të dispozitave të ligjit që rregullon parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike dhe ndalimeve të parashikuara nga Kodi i Sjelljes, listohen si kufizim në ushtrimin e veprimtarisë tregtare:

- ndalimi për zotërimin e të drejtave mbi kapitalin në shoqëritë tregtare, përfshin si shoqëritë tregtare persona juridikë shqiptarë, ashtu edhe të huaj, por që zotërojnë pozita dominuese në tregun e brendshëm;

- ndalimi i pjesëmarrjes në tendera; si dhe

- pengimi i ushtrimit të veprimtarisë private si person fizik nga vetë deputeti dhe lidhja e kontratave që dukshëm kanë për qëllim justifikimin e përfitimeve nga veprimtaria tregtare e një ose më shumë personave fizikë të tjerë, për sa kohë që personi fizik krijon të ardhura të krahasueshme me ato që deputeti përfiton nga lidhja e kontratave me të.

Ushtrimi i të drejtave të pronësisë konsiderohet si zotërim aktiv kur deputeti ruan të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, por nuk mund të ushtrojë të drejta mbi kapitalin ose pjesë të tij e që i zotëronte gjatë kohës kur nuk ushtronte funksionin si deputet. E drejta e përfitimit nga frytet e pasurisë sigurohet nga marrëveshja që lidhet midis deputetit, ish-zotërues i të drejtave, dhe pronarit të ri mbi këto të drejta.

11

Në zbatim të pikës 6, të nenit 17, të Kodit të Sjelljes, për vlerësimin e kushtit të kufizimit të veprimtarisë tregtare, kontrata ose pjesëmarrje në kapital të bashkëshortit/bashkëjetuesit, fëmijët e rritur dhe prindërit e deputetit, konsiderohen njësoj sikur të ishin në emër dhe për llogari të vetë deputetit.

Në zbatim të dispozitave të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, së bashku me dispozitën e cituar të Kodit të Sjelljes, zotërimi aktiv i të drejtave mbi kapitalin e një shoqërie tregtare, që rezulton me pozita dominuese në treg, nga bashkëshorti/bashkëjetuesi, fëmijët e rritur dhe prindërit e deputetit është njësoj sikur këto të drejta të zotëroheshin në mënyrë aktive nga vetë deputeti.

Verifikimi i kushtit të kufizimit në veprimtari tregtare bëhet:

- në çdo fillim legjislature;
- për çdo deputet të ri brenda një legjislature; si dhe
- sa herë ka informacione të reja për deputetë të caktuar e që rezultojnë:
 - o nga formulari i interesave privatë; ose
 - o nga informacione të bëra publike rishtazi.

Kuvendi, çdo fillim legjislature, brenda tre muajve nga depozitimi i deklaratës së konfliktit të interesave, i dërgon për verifikim dhe vlerësim Autoritetit të Konkurrencës listën e plotë të deputetëve që, si pjesë të deklarimeve të veta, kanë plotësuar edhe të dhënat për pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive tregtare. Për efekt të këtij verifikimi, në zbatim të Kodit të Sjelljes, konsiderohen dhe dërgohen për verifikim edhe rastet kur të drejtat mbi kapitalin zotërohen nga bashkëshorti/bashkëjetuesi, fëmijët e rritur dhe prindërit e deputetit.

Nëse nga përgjigjja e Autoritetit të Konkurrencës deputeti rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të nenit 17 të Kodit të Sjelljes, ndaj tij fillojnë procedurat e heqjes së mandatit.

I njëjti trajtim bëhet edhe në rastet kur kushtet e ndalimit, të parashikuara nga neni 17, i Kodit të Sjelljes, konstatohen gjatë verifikimit të kufizimeve gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit ose për çdo deputet të ri gjatë legjislaturës.

Për kufizimet dhe ndalimin e pjesëmarrjes në tendera referohen standardet e vendosura dhe të zbatuara nga ILDKPKI në “Manualin mbi parandalimin e konfliktit të interesave në prokurimet publike”.³

³ *Për orientim në vijim është një ekstrakt nga :*

“MANUAL MBI PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË PROKURIMET PUBLIKE

Neni 26 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”:

· Autoriteti kontraktues refuzon një ofertë ose një kërkesë për Neni 26 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”:

· Autoriteti kontraktues refuzon një ofertë ose një kërkesë për pjesëmarrje në tender nëse ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit.pjesëmarrje në tender nëse ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit.

Duke u bazuar në pikën 1 të nenit 21 dhe në pikën 1 të nenit 24 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, dallojmë:

1- Zyrtarët e përfshirë në ndalim janë zyrtarë të nivelit të lartë të përmendur në seksionin 2 të kreut III të ligjit PKI. Zëvendësministri bën pjesë në këtë kategori zyrtarësh.

2- Llojet e kontratave të ndaluara - Ndalimi i natyrës absolute përfshin të gjitha llojet e kontratave si: prokurimi publik i ndërtimeve, mallrave ose shërbimeve, shitja, shkëmbimi, qiraja/enfiteoza, dhurimi, furnizimi, sipërmarrja, transporti dhe çdo kontratë tjetër që nuk përjashtohet nga pika 5 e nenit 21 në ligj. Kontrata e ndërtimit bën pjesë në këtë kategori.

3- Llojet e interesave - Për qëllim të nenit 21, pika 1, merren në konsideratë vetëm rastet kur zyrtari shfaqet si palë kontraktuese me një institucion publik si individ, ose një shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë, në të cilën ai (ose personat e lidhur me të) zotëron në mënyrë aktive ose pasive aksione, ose pjesë në kapital, në çfarëdo sasive.

Shembulli 1:

Vajza e zyrtarit zotëron aksione në shoqërinë tregtare “Dajti” sh.a., e cila është paraqitur në prokurimin e fondeve publike që organizohet nga bashkia e qytetit Z.

Bazuar në të dhënat e rastit, dhe bazës ligjore të sipërcituar, konstatojmë se shoqëria tregtare “Dajti” sh.a., ku është aksionere vajza e zëvendësministrit, është në konflikt interesi nëse merr pjesë në prokurimin publik për ndërtimin e shkollës në bashkinë Z, sepse:

· Funkzioni i zëvendësministrit është funksion i nivelit të lartë dhe vajza i tij është person i lidhur. Ndalimet për personin e lidhur janë njëllor si për zyrtarin.

Kufizimi i imunitetit*Udhëzime për zbatimin e nenit 19 të Kodit të Sjelljes*

Dispozita e Kodit të Sjelljes dhe çdo kërkesë procedurale ose procedurë disiplinore e lidhur me masat shtrënguese, në funksion të respektimit të Kodit të Sjelljes, nuk lidhet dhe as ndërthuret me procedura që trajtojnë të drejta ose kufizime të të drejtave në funksion të imunitetit parlamentar. Koncepti i imunitetit parlamentar përcakton se anëtarëve të parlamentit u jepet një shkallë mbrojtjeje e veçantë ndaj vendosjes së masave penale.

Imuniteti parlamentar është një bllok garancish, kryesisht procedurale, që i sigurojnë në nivel fundor:

- deputetit, në cilësi personale për përmbushjen e mandatit të tij, pa pasur frikë nga ngacmimet, ndërhyrjet ose akuzat e papërshtatshme nga organet e pushtetit ekzekutiv, gjykatat ose kundërshtarët politikë ose nga forca politike që përfaqëson; dhe

- deputetit, në cilësi të anëtarit të Kuvendit (si mbajtës i pushtetit ligjvënës), në funksion të sigurimit të garancive për institucionin si pushtet i pavarur, i pacenueshëm nga pushtete të tjera.

Mekanizmi i paketës së të drejtave të posaçme procedurale mbi imunitetin nuk ka lidhje vetëm me të drejtat e posaçme që i sigurojnë individit të zgjedhur deputet lirinë mbi pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit ose vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësisë të tyre. Gëzimi i të drejtave procedurale, të lidhura me imunitetin e deputetit, nuk

· Shoqërisë tregtare "Dajti" sh.a., ku është aksionere vajza e zëvendësministrit, nëse paraqitet në prokurimin e organizuar nga një institucion publik, bazuar në nenin 26, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, autoriteti kontraktues do t'ia refuzojë ofertën ose kërkesën për pjesëmarrje në tender, meqenëse ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit.

Në pikën 1, të nenit 24, të ligjit, PKI përcaktohen si persona të lidhur me zyrtarin: bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es. Bazuar në këtë dispozitë, rezulton se shoqëria tregtare ku personi i lidhur, fëmija në moshë madhore (në rastin e sipërcituar, vajza), zotëron aksione, është në konflikt interesi, si në rastin kur vajza është pjesë e trungut familjar të zyrtarit, ashtu edhe kur është e ndarë më vete nga trungu familjar.

Shembulli 2:

Zyrtari B.N. është deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Djali i tij i martuar zotëron 14 % të aksioneve në shoqërinë tregtare "DRINI" sh.a. Kjo shoqëri ka aplikuar në tenderin e organizuar nga drejtoria e përgjithshme e institucionit X, për rindërtimin e ndërtesës.

Pyetje për diskutim:

A ka kufizim ligjor për pjesëmarrjen e shoqërisë tregtare "DRINI" sh.a. në tenderin e organizuar nga institucioni publik X?

Analiza e rastit:

Shoqëria tregtare "DRINI" sh.a, bazuar në nenin 26, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", mbart detyrimin për deklarim të konfliktit të interesit, duke plotësuar dokumentin zyrtar të miratuar me vendim nr. 1, datë 04.02.2009, të APP-së. Në rastin konkret, shoqëria tregtare "DRINI" sh.a. e ka dërguar dokumentacionin e nevojshëm nëpërmjet postës elektronike për të aplikuar në tenderin e organizuar nga institucioni publik X. Në dokumentet standarde të tenderit ka plotësuar edhe dokumentin "Deklarim mbi konfliktin e interesave". Nga verifikimi i këtij deklarimi rezulton se aksioner i shoqërisë "DRINI" sh.a. është djali i deputetit B.N. që zotëron 14 % të aksioneve.

Bazuar në këtë fakt, autoriteti kontraktues bën analizën dhe trajtimin e rastit si vijon:

- në rastin konkret, zyrtari B.N. klasifikohet zyrtar i nivelit të lartë dhe për rrjedhojë përfshihet në ndalimin e natyrës absolute, të parashikuar nga pika 1, e nenit 21, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003;

- djali është person i lidhur dhe për këtë gjen zbatim i njëjti ndalim si për vetë zyrtarin (neni 24 i ligjit PKI);

- kufijtë e zotërimit të aksioneve janë të njëjtë me ata të përcaktuar në nenin 21, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, edhe për çdo person të lidhur me zyrtarin;

- drejtoria e përgjithshme e institucionit X është institucion publik.

Bazuar në këto të dhëna, komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se pjesëmarrja e shoqërisë tregtare "DRINI" sh.a. në tenderin e organizuar për rindërtimin e ndërtesës është në konflikt interesi të natyrës absolute.

Ky kufizim nuk ka lidhje me vendimmarrjen për aktin, por me kategorinë e zyrtarit, pra me funksionin e tij.

Mënyra e zgjidhjes:

Duke analizuar të dhënat e sipërcituara, komisioni i vlerësimit të ofertave të institucionit publik X, bazuar në pikën 1, të nenit 26, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, duhet të vendosë ta skualifikojë shoqërinë tregtare "DRINI" sh.a. Njofton në mënyrë elektronike shoqërinë tregtare "DRINI" sh.a. për vendimin e marrë dhe vijon punën me ofertat e tjera të paraqitura nga shoqëritë e tjera tregtare të paraqitura në këtë tender.

ka si qëllim t'i vendosë ata mbi ligjin, por synon mbrojtjen e individit të zgjedhur, në kufijtë e cilësive të tij si anëtar i Kuvendit.

Ky mekanizëm procedural është mbrojtje e veçantë ligjore, kur ndaj tyre kërkohet masa e arrestit, heqja e lirisë në çfarëdolloj forme, ose ushtrimi i kontrollit personal të banesës nga organi i akuzës dhe që shërben si filtër i verifikimit, nëse kërkesa synon presionin, destabilizimin, ose cenimin e pavarësisë së institucionit.

Dispozitat procedurale, që parashikojnë rregullat dhe mënyrën e shqyrtimit dhe lëshimit të autorizimeve për kufizim të të drejtave të deputetit, kanë si qëllim që, nëpërmjet procedurave, të verifikohet nëse kërkesat e paraqitura nga organe që përfaqësojnë pushtete të tjera të pavarura, synohet ose tentohet që nëpërmjet goditjes së individit, të dëmtohet ose të preket funksionimi normal dhe pavarësia e institucionit.

Dispozitat procedurale për imunitetin parlamentar, pavarësisht se i japin deputetit një mbrojtje më të madhe se shtetasve të tjerë, nuk duhet të keqpërdoren për pengimin e drejtësisë, pasi në këtë mënyrë çojnë në uljen e besimit të publikut ndaj Kuvendit.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, gjatë shqyrtimit të kërkesave, kur për deputetë të caktuar kërkohet masa e arrestit, heqja e lirisë në çfarëdolloj forme, ose ushtrimi i kontrollit personal, duhet të mbajë në konsideratë sa më sipër, duke vlerësuar se në çdo rast procedura parlamentare bëhet për t'i hapur rrugë shqyrtimit të kërkesës në organe të një pushteti tjetër.

Gjatë procedurave parlamentare për heqjen e imunitetit, deputeti, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, duhet të tregohet i gatshëm që të marrë pjesë dhe të dëgjohet në mbledhjet e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, të paraqesë çdo dokument ose dëshmi tjetër me shkrim, që konsiderohet nga ai me rëndësi për çështjen, si dhe të kryejë çdo veprim tjetër që i kërkohet, sipas Rregullores së Kuvendit.

16

Veprimtari joparlamentare të lejuara për deputetin *Udhëzime për zbatimin e nenit 20 të Kodit të Sjelljes*

Ushtrimi i mandatit të deputetit është aktiviteti kryesor i tij gjatë të gjithë kohëzgjatjes së legjislaturës. Veprimtari të tjera, të natyrës profesionale (mësimdhënie, pjesëmarrje në konferenca shkencore, publikime), artistike, social-kulturore, sportive, ose të një natyre të ngjashme me to, janë të lejueshme për sa kohë që nuk bien ndesh me funksionin e tij dhe nuk paraqesin konflikt interesi. Gjithashtu, konsiderohet veprimtari joparlamentare veprimtaria në kuadër të shoqatave kulturore, shoqërore ose sportive dhe pjesëmarrja në organet drejtuese të këtyre shoqatave, për sa kohë që nuk bie ndesh me funksionin e tij si deputet.

Çdo veprimtari joparlamentare e deputetit, e kryer gjatë kohës së ushtrimit të mandatit dhe që mund të rezultojë me kombinime të interesave dhe/ose me implikime për ushtrimin e mandatit, duhet t'i bëhet e ditur menjëherë kryetarit të grupit përkatës, Kryetarit të Kuvendit dhe Byrosë së Kuvendit.

Gjatë ushtrimit të veprimtarive joparlamentare, deputeti duhet të shmangë çdo lloj publiciteti ose përdorimi mediatik të veprimtarisë, që mund të shkaktojë konfuzion te publiku lidhur me funksionin e tij.

Gjatë ushtrimit të veprimtarive joparlamentare, deputeti nuk mund të pranojë asnjë kompensim ose përfitim tjetër financiar, përveç atyre të parashikuara në ligj.

Veprimtari e deputetit në mbrojtje të lobizmit
Udhëzime për zbatimin e nenit 21 të Kodit të Sjelljes

Si koncept i një realiteti demokratik pluralist, stabiliteti dhe transparenca e këtij sistemi sigurohen edhe nëpërmjet veprimtarisë së lobizmit, për sa kohë që interesat legjitimë që mbrohen deklarohen në mënyrë të qartë dhe transparente.

Përtej konotacionit negativ, lobizmi, në përkufizimin teknik të termit, ndjek qëllime të mira e që i shërbejnë transparencës ose edhe denoncimit të praktikave korruptive ose klienteliste.

Lobisti, si ushtrim funksioni, ka si synim që të gjitha detajet, përfshirë ato të padukshme për publikun e gjerë, të bëhen të dukshme, duke bërë publike informacione që pavarësisht se mbrojnë interesa specifike, janë të nevojshme për të krijuar një pamje të plotë të problemit që qëndron pas një vendimmarrjeje politike.

Lobist nënkupton:

- një person teknik, që përfaqëson një grup interesi, i cili ka si synim që të ndërtojë ura komunikimi me personat përfaqësues të institucioneve ose organeve që kanë rol vendimmarrës në proces, me qëllim që të ndikojë mbi to, duke kërkuar ndryshimin e një rregulli, norme ose dispozite, duke bërë rolin e mbrojtësit, si dhe duke kërkuar që çështja të bëhet temë e agjendës politike;

- organizata jofitimprurëse, që janë shprehur në terma lobizmi për çështje të caktuara, ose përfaqësojnë grupe sociale qartësisht të shprehura;

- organizata biznesi, që angazhojnë lobistë profesionistë ose formatojnë qëndrime të identifikuar si lobizëm.

Lobisti bën publike interesat privatë të posaçëm, të cilët beson se shteti nuk i njeh mjaftueshëm dhe të cilët për këtë shkak mund të sakrifikohen në favor të interesave ose objektivave të tjerë. Qëllimi i lobizmit është që, duke i deklaruar këta interesa, të mund të vihet në funksionim mekanizmi i pjesëmarrjes në vendimmarrje, qoftë edhe nëpërmjet ekspozimit të interesave të tjerë, për të cilët grupi i interesit, i mbrojtur nga lobisti, zgjidhet të sakrifikohet nga vendimmarrja politike.

Deputeti konsiderohet në mbështetje të një lobizmi, atëherë kur ai deklarohet në mbrojtje të interesave të mbrojtur dhe të deklaruar si më sipër nga lobistë që e ushtrojnë në praktikë këtë veprimtari si persona teknikë të fushës.

Veprimtaria e deputetit konsiderohet në mbështetje të një lobizmi edhe në ato raste kur nisma mbështetet publikisht, ose është hartuar me asistencë ose si pjesë e projekteve të organizatave jofitimprurëse, me të cilat deputeti ka pasur një historik personal të anëtarësimit ose drejtimit të organizatës.

Deklarimi i lidhur me procesin ligjvënës, në rastet kur nisma mbështetet publikisht ose është hartuar me asistencën ose si pjesë e projekteve të organizatave jofitimprurëse, përfshin deklarimin e lidhjes së deputetit me organizatën jofitimprurëse dhe historikun personal të anëtarësimit ose angazhimeve personale në raport me organizatën jofitimprurëse.

Përveç konceptit dhe përshkrimit teknik të lobizmit, për efekt të zbatimit të Kodit të Sjelljes, duhet të konsiderojmë edhe përshkrimin popullor për të. Në fjalorin popullor dhe jo vetëm, në Shqipëri lobizmi i deputetëve, interpretohet shpesh edhe nga vetë ata si sigurim i kushteve për punësim ose emërim në pozicione të votuara nga Kuvendi. Për efekt të interpretimit dhe zbatimit të Kodit të Sjelljes, ky lloj lobizmi është absolutisht i ndaluar dhe përbën keqpërdorim të figurës së deputetit.

Regjistri i lobizmit, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile
Udhëzime për zbatimin e nenit 22 të Kodit të Sjelljes

Shërbimi i Trajtimit të Deputetëve, në bashkëpunim me Koordinatorin e Shoqërisë Civile, riorganizojnë dhe përditësojnë regjistrin elektronik të lobizmit në Kuvend.

Regjistri i lobimit organizohet mbi bazën e listës së komisioneve të përhershme parlamentare dhe duhet të përmbajë të paktën këto të dhëna:

1. Listën e lobistëve të vetëdeklaruar në çdo fillim legjislature, të ndarë sipas fushave të përgjegjësive të komisioneve të përhershme parlamentare.

2. Takimet e komisionit përkatës me lobistë, organizata të shoqërisë civile ose grupe të interesit.

3. Deklarata me shkrim të deputetit në lidhje me takimet me lobistë, objektin e takimeve dhe shkallën e mbështetjes që do të sigurojë për kërkesat e paraqitura.

4. Nëse takimi është bërë nga deputetë dhe jo nga komisione, emrin/emrat e deputetëve që janë kontaktuar dhe takuar me lobistë, organizata të shoqërisë civile ose grupe të interesit, duke përshkruar listën e pjesëmarrësve.

5. Procesverbalet e takimeve.

Për qëllime të ushtrimit të funksioneve si lobistë në faqen zyrtare të Kuvendit, çdo fillim legjislature publikohet njoftimi që fton lobistë profesionistë, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile që të shprehin interesin për akreditim pranë komisioneve të përhershme parlamentare.

Përkufizimi i dhuratës dhe përfitimeve të tjera të ngjashme
Udhëzime për zbatimin e nenit 23 të Kodit të Sjelljes

Me “dhuratë”, në zbatim të kufizimeve dhe ndalimeve të parashikuara në Kodin e Sjelljes, kuptohet çdo send që i jepet deputetit pa shpërblim nga të tjerë në veprimtari të ndryshme parlamentare, gjatë të cilave deputeti, i vetëm ose si pjesë e një delegacioni, përfaqëson zyrtarisht Kuvendin, sipas përcaktimeve të nenit 40, pika 1, të Regullores së Kuvendit.

Me “përfitime të tjera të ngjashme” kuptohen rastet kur deputeti merr pjesë në veprimtari të organizuara nga të tjerë dhe pjesëmarrja e tij, shpenzimet e udhëtimit, të strehimit dhe të qëndrimit mbulohen prej palës pritëse ose të tretëve.

Deputeti nuk duhet të kërkojë ose të pranojë dhurata, ose çfarëdo përfitimi tjetër të ngjashëm, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat kanë marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, ose janë a duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare. Në qoftë se ofrohet një përfitim i padrejtë, deputeti duhet:

a) ta refuzojë, pa pasur nevojë ta pranojë atë për ta përdorur si provë;

b) të përpiqet që ta identifikojë personin që i bën ofertën;

c) të shmangë kontaktet e gjata me personin që bëri ofertën;

ç) në qoftë se dhurata nuk mund të refuzohet që t'i kthehet dërguesit, ajo deklarohet dhe dorëzohet sipas procedurës së parashikuar nga ky udhëzues.

Deklarimi, dorëzimi dhe ruajtja e dhuratave
Udhëzime për zbatimin e nenit 23 të Kodit të Sjelljes

Sipas parashikimit të pikës 9, të nenit 23, të Kodit të Sjelljes, deputeti, brenda 5 ditëve nga marrja e dhuratës, njofton Byronë e Kuvendit për pranimin e dhuratës, duke specifikuar në

veçanti emrin e dhuruesit, datën dhe rrethanat e marrjes së dhuratës, vlerën e përafërt, si dhe një përshkrim të shkurtër të saj. Deklarimi i dhuratës bëhet sipas formularit bashkëngjitur këtij Udhëzuesi.

Shërbimi për Trajtimin e Deputetëve i komunikon deputetit vendin e dorëzimit të dhuratës, në përputhje me detyrimin e parashikuar në nenin 23, pika 8, të Kodit të Sjelljes.

Përfundimisht, deputeti ka të drejtë të mos e deklarojë dhuratën kur vlera e saj, në gjykimin e deputetit, është nën kufirin e parashikuar në nenin 23, pika 1, të Kodit të Sjelljes, dhe kur nuk paraqet ndonjë rëndësi të veçantë për Kuvendin. Në rrethana të tilla, dhurata bëhet pronë e deputetit.

Në rast se ngrihen dyshime, deputeti e dorëzon dhuratën pranë Shërbimit të Trajtimin të Deputetëve, i cili e merr në dorëzim duke zbatuar për analogji rregullat e hyrjes në magazinë. Në rast se Shërbimi i Trajtimin të Deputetëve vlerëson se dhurata e marrë e tejkalon kufirin e vlerës së përcaktuar në nenin 23, pika 1, të Kodit të Sjelljes, zbatohen rregullat e parashikuara në lidhje me ruajtjen dhe ekspozimin e dhuratave.

Kur deputeti ka pranuar një dhuratë në mirëbesim të plotë dhe më pas ka kuptuar se vlera e saj është mbi kufijtë e parashikuar në nenin 23, pika 1, të Kodit të Sjelljes, e deklaron atë menjëherë, sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij Udhëzuesi dhe e dorëzon pranë Shërbimit të Trajtimin të Deputetëve nëse, për arsye kortezie, dhurata nuk mund t'i kthehet dhuruesit.

21

Përfitimet e tjera të ngjashme, shpenzimet e mbuluara nga të tjerët *Udhëzime për zbatimin e nenit 23 të Kodit të Sjelljes*

Deputeti duhet të deklarojë kur merr pjesë në veprimtari të organizuara nga të tjerë dhe pjesëmarrja e tij, shpenzimet e udhëtimit, strehimit dhe të qëndrimit mbulohej prej palës pritëse ose të tretëve.

Bëjnë përjashtim nga detyrimi për deklarim rastet kur shpenzimet e paguara përfshijnë shpenzimet për qëndrim, ushqim, transport etj., vlera e të cilave rezulton nën vlerën e parashikuar në nenin 23, pika 1, të Kodit të Sjelljes.

Detyrimi për deklarim nuk zbatohet në rastet e delegacioneve zyrtare që përfaqësojnë Kuvendin e Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

22

Ruajtja, ekspozimi dhe regjistrimi i dhuratave *Udhëzime për zbatimin e nenit 23 të Kodit të Sjelljes*

Shërbimi i Trajtimin të Deputetëve administron dhuratat e pranuar. Dhuratat ruhen në mjediset e Kryesisë së Kuvendit.

Byroja e Kuvendit, mbështetur në rekomandimin e Sekretariatit për Statusin e Deputetit, mund të vendosë që dhuratat me vlerë artistike dhe kulturore të ekspozohen në mjediset e përshtatshme të Kuvendit. Kur çmohet nga Byroja e Kuvendit, mbështetur në kërkesën me shkrim të deputetit, dhurata mund të ekspozohet në vetë zyrën e deputetit, për sa kohë ky i fundit mban funksionin, për shkak të të cilit ka marrë dhuratën në fjalë.

Sekretariati për Statusin e Deputetit mund t'i japë udhëzime Shërbimit të Trajtimin të Deputetëve rreth ruajtjes dhe përdorimit të dhuratave.

Shërbimi i Trajtimin të Deputetëve mban një regjistër të veçantë elektronik për dhuratat pronë e Kuvendit të Shqipërisë, sipas modelit bashkëngjitur këtij Udhëzuesi.

1. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:
 - emër/mbiemër të deputetit;
 - funksionin, për shkak të të cilit deputeti i është dhënë dhurata;

- emër/mbiemër të dhuruesit dhe institucioni që përfaqëson dhuruesi;
- përshkrim i shkurtër i dhuratës;
- vlerën e saj, sipas gjykimit të deputetit (>10 000 lekë/< 10 000 lekë);
- foto të dhuratës;
- datën e pranimit të dhuratës;
- datën e deklarimit të dhuratës;
- strukturën përgjegjëse/Shërbimi i Trajtimit të Deputetëve;
- nëse shihet e arsyeshme, edhe vendin ku është ekspozuar dhurata në fjalë, sipas nenit 3, pikat 3 dhe 4.

Regjistri publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme për publikun. Si pjesë e regjistrimit të dhuratave publikohen edhe kopje të skanuara të formularëve të deklarimit të mbulimit të shpenzimeve, në rastet kur shpenzimet janë mbuluar nga të tretët.

Formulari i deklarimit të mbulimit të shpenzimeve, sipas modelit bashkëlidhur këtij Udhëzuesi, përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emër/mbiemër, funksionin dhe adresën e të tjerëve, të cilët kanë marrë përsipër pagimin ose rimbursimin e shpenzimeve të deputetit;

b) llojin e shpenzimeve të paguara ose të rimbursuara, plotësisht ose pjesërisht (shpenzime udhëtimi, fjetjeje, qëndrimi);

c) vendin ku është zhvilluar veprimtaria, si dhe tipologjinë/natyrën e veprimtarisë së zhvilluar (konferencë, seminar, trajnim etj);

ç) datën dhe kohëzgjatjen e pjesëmarrjes së deputetit;

d) programin e veprimtarisë;

dh) informacione të tjera të mundshme nëse dëshiron.

Plotësimi dhe dorëzimi i formularit të deklarimit të mbulimit të shpenzimeve bëhet brenda 15 ditëve nga data e fundit e pjesëmarrjes së deputetit në veprimtarinë e zhvilluar.

23

Transparenca e veprimtarisë parlamentare të deputetit

Udhëzime për zbatimin e nenit 24 të Kodit të Sjelljes

Deputeti duhet t'i referohet procedurës parlamentare në lidhje me propozimin, arsyetimin dhe mbrojtjen e nismave ose amendamenteve, gjatë fazës së diskutimit të projektakteve.

Çdo propozim që synon shtesa, ndryshime ose korrigjime të teksteve të akteve që shqyrtohen në një procedurë parlamentare, në komisione, organe të Kuvendit ose seancë plenare, duhet të bëhet me shkrim e të plotësojë të paktën kriteret formale të lidhura me relacionet dhe analizat shoqëruese, duke përfshirë shpjegimet për lobimin (nëse është rasti), opinionin personal, si dhe grupin e interesit që përfiton nga nisma.

Nuk mund të vlerësohet si propozim për nisma, ose amendamente, referenca të fjalimet e mbajtura në seanca. Deputeti nuk mund të deklarojë publikisht ose të pretendojë depozitimin e nismave ose ndryshimeve ligjore ose akteve të tjera që shqyrtohen nga Kuvendi, në rast se nuk ekzistojnë tekste të dokumentuara, të formuluar dhe të nënshkruara sipas kërkesave të Rregullores së Kuvendit dhe të depozituara sipas parashikimeve të dispozitave të Rregullores së Kuvendit dhe dispozitave në fuqi.

Respektimi i rregullave të përshkruara më sipër është i domosdoshëm për të futur në procedurë shqyrtimi dhe votimi të propozimeve të ndryshimeve ligjore, i kontributeve të tjera në vendimmarrjen politike, ose në akte të tjera të miratuara në Kuvend.

24

Transparenca e projekteve me Kuvendin

Udhëzime për zbatimin e nenit 25 të Kodit të Sjelljes

Neni 25 i Kodit parashikon se në rastet kur fondet për projektet që sigurojnë asistencë për hartim legjislativ janë siguruar nga organizata të shoqërisë civile ose grupe interesi, transparenca financiare dhe shpenzimet e projektit publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.

Struktura përgjegjëse në Kuvend, që mbulon sektorin e zbatimit të projekteve, ndjek përmbushjen e këtij detyrimi duke kërkuar dhe mbledhur të gjithë informacionin e nevojshëm nga donatorët dhe palët e tjera të përfshira, me qëllim mbledhjen e të dhënave specifike të projektit (konceptin dhe karakteristikat e projektit, kohëzgjatjen, fazat e ciklit të projektit, hartimin e tij, si dhe vlerësimin e treguesve financiarë të projektit).

25

Konfidencialiteti

Udhëzime për zbatimin e nenit 26 të Kodit të Sjelljes

Respektimi i parimit të ruajtjes së konfidencialitetit kërkon që deputeti:

- të sigurojë mospërhapjen dhe konfidencialitetin për të dhënat që i janë bërë të ditura, kur ato përbëjnë “sekret shtetëror”, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës funksionale;
- të përdorë dhe të administrojë me përgjegjësi dokumentacionin, për të cilin merr dijeni për shkak të funksionit;
- detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin, shtrihet gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës;
- të dhënat personale dhe konfidenciale mund të përdoren vetëm nëse nevojiten për realizimin e detyrave funksionale dhe nuk duhet t’i përdorin për përfitim personal;
- të marrë masa të parandalojë dhe të mbrojë rrjedhjen e informacionit, të të dhënave sensitive dhe konfidenciale, në zbatim të detyrimeve ligjore për mosnxjerrjen ose publikimin e informacionit;
- të gëzojë lirinë e opinionit personal, duke respektuar ruajtjen e konfidencialitetit në qëndrimet ose deklaratat në mediat e shkruara dhe elektronike, gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksionit.

26

Kufizimet pas përfundimit të mandatit

Udhëzime për zbatimin e nenit 27 të Kodit të Sjelljes

Pas përfundimit të mandatit, deputeti vazhdon të udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, ndershmërisë, objektivitetit, transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit. Marrëdhëniet e deputetit me Kuvendin, për sa i përket ndonjë privilegji ose detyrimi, (të parashikuar nga legjislativ në fuqi për statusin e deputetit), vazhdojnë edhe pas mbarimit të mandatit. Nenet 26-27 të Kodit të Sjelljes bëjnë fjalë pikërisht për “detyrimet” e deputetit pas mbarimit të mandatit. Këto detyrime ose kufizime janë të përhershme dhe të përkohshme.

- Kufizimet e përhershme kanë të bëjnë me ruajtjen e informacionit konfidencial, të klasifikuar si të tillë, dhe që deputeti e ka marrë gjatë ushtrimit të mandatit të tij si deputet, për shkak të funksionit që ai ka kryer. Shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” është e dënueshme sipas ligjeve në fuqi.

- Kufizimet e përkohshme kanë të bëjnë me përfshirjen e ish-deputetit për një periudhë njëvjeçare pas përfundimit të mandatit në:

- marrëdhënie kontraktuale konsulence me Kuvendin, që përfshin çdo shërbim konsulence, i një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese;
- kontratë pune ose biznesi me Kuvendin, që përfshin çdo marrëdhënie kontraktuale midis Kuvendit të Shqipërisë dhe ish-deputetit që ushtron veprimtari private në formën e personit fizik tregtar;
- ushtrimin e avokatisë, kur si palë kundërshtare në procesin gjyqësor është Kuvendi i Shqipërisë.

Kufizimet e mësipërme shtrihen për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga dita e mbarimit të mandatit të deputetit. Gjatë kësaj periudhe ish-deputeti është në konflikt interesi me Kuvendin. Pas kësaj periudhe ai lirohet nga çdo lloj kufizimi i përkohshëm.

Çdo ish-deputet, kur ka dyshime se angazhimi i tij në marrëdhëniet e reja të punës përfshihet në rastet e kufizimeve të parashikuara në nenin 27, të Kodit të Sjelljes, vë në dijeni Byronë e Kuvendit. Byroja e Kuvendit, pasi shqyrton rastin në fjalë, analizon dhe vlerëson kufizimet e përcaktuara në nenin 27, të Kodit të Sjelljes, dhe vë në dijeni ish-deputetin. Vendimi i Byrosë së Kuvendit publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet, duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave personale të ish-deputetit. Në raste të caktuara, Byroja e Kuvendit mund të kërkojë edhe mendimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, si organi kompetent për interpretimin e dispozitave të Kodit të Sjelljes.⁴

27

Vlerësimi i standarteve etike të Kodit

Udhëzime për zbatimin e nenit 28 të Kodit të Sjelljes

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin është organi kompetent që në mënyrë periodike bën:

- vlerësimin e plotë të standardeve etike nga deputeti;
- nivelin e zbatueshmërisë nga deputeti të Kodit, e shprehur si përqindje mbi tërësinë e rregullave të Kodit të Sjelljes; dhe
- ndikimin që këto standarde kanë pasur në veprimtarinë politike të deputetit.

Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se 8 muaj përpara përfundimit të legjislaturës, thërret mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

⁴ Për t'i bërë më lehtësisht të kuptueshme kufizimet e përkohshme sjellim disa shembuj ilustrativë.

Shembuj ilustrativë

Shembulli 1

Ish-deputeti, menjëherë pas mbarimit të mandatit, kërkon të ushtrojë veprimtari private, duke ushtruar profesion të lirë (psh avokat). Kodi i Sjelljes nuk e pengon ish-deputetin të ushtrojë veprimtari private (në këtë rast ushtrimin e avokatisë), por kufizon ish-deputetin në rastet e proceseve gjyqësore ku palët ndërgjyqëse janë: Kuvendi i Shqipërisë dhe pala tjetër e përfaqësuar nga ish -deputeti në cilësinë e avokatit.

Shembulli 2

Kuvendi i Shqipërisë hap procedurat e prokurimit me objekt sigurim i shërbimit të konsulencës ligjore. Supozojmë se një ndër operatorët ekonomikë është edhe një ish-deputet, i cili në procedurat e prokurimit shpallet fitues dhe për pasojë do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale konsulence me Kuvendin. Kodi i Sjelljes e kufizon ish-deputetin në lidhjen e kontratës nëse ai është brenda afatit 1-vjeçar nga mbarimi i mandatit.

Shembulli 3

Ish-deputeti, pas mbarimit të mandatit, zotëron aksionet e një shoqërie tregtare, e cila merr pjesë në procedura prokurimi dhe shpallet fituese. Në këtë rast ish-deputeti ka kufizime vetëm nëse autoriteti kontraktor është Kuvendi i Shqipërisë.

Shembulli 4

Ish-deputeti, pas mbarimit të mandatit, kërkon të bëhet pjesë e shërbimit civil në administratën e Kuvendit si nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese (Sekretar i Përgjithshëm/Drejtor Departamenti/Drejtor Drejtorie të Përgjithshme). Pranimi në shërbimin civil bëhet nëpërmjet konkurrimit. Në këtë rast ish-deputeti pengohet për të marrë pjesë në procedurat e konkurrimit për shkak të kufizimeve që paraqet neni 27 i Kodit të Sjelljes. Ai nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale pune individuale me Kuvendin përpara përfundimit të periudhës 1-vjeçare të parashikuar në dispozitën e sipërcituar.

Në mbledhjen e parë të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit që bashkëpunojnë ngushtë me Kuvendin dhe që janë të regjistruara në regjistrin elektronik të lobizmit si shoqëri civile.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, për vlerësimin e standardeve etike të Kodit, si dhe ndikimin që këto standarde kanë pasur në veprimtarinë politike parlamentare të deputetit, merr në konsideratë:

- materialet ose raportet vjetore të Byrosë së Kuvendit, lidhur me rastet e shkeljes së Kodit të Sjelljes, si dhe masat disiplinore të marra ndaj deputetëve për këto shkelje;

- përshkrim të rasteve të shkeljes së Kodit gjatë legjislaturës;

- regjistrin e masave disiplinore;

- jurisprudencën shqiptare, si dhe ndryshimet në legjislacionin shqiptar për çështjet e trajtuara nga Kodi i Sjelljes;

- praktikën ndërkombëtare në lidhje me çështjen.

Këshilli analizon, diskuton dhe vlerëson, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Sjelljes, efektet e standardeve etike dhe, brenda një muaji nga mbledhja e parë, harton një raport dhe ia paraqet seancës plenare. Raporti i Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin nuk është objekt diskutimi në seancë plenare. Brenda një muaji nga paraqitja e raportit nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, Kuvendi miraton raportin.

Kur nevojitet marrja e nismës për plotësime ose ndryshime në Kodin e Sjelljes, bashkë me vlerësimin vjetor i paraqiten seancës edhe rekomandimet përkatëse.

Menjëherë pas miratimit, Kryetari i Kuvendit urdhëron që raporti të publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme për publikun.

Shërbimi i Seancës Plenare është struktura përgjegjëse që përgatit dhe ndjek zhvillimin e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Bazuar në raportin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, të miratuar në seancën plenare, çdo deputet, grup parlamentar ose komision i përhershëm mund të ndërmarë nismën për ndryshime në Kod. Ndryshimet e propozuara lidhen ngushtë me çështjet e parashtruara nga Këshilli në raportin e vlerësimit të standardeve të Kodit.

28

Interpretimi i Kodit të Sjelljes

Udhëzime për zbatimin e nenit 29 të Kodit të Sjelljes

Në zbatim të parashikimeve të kompetencës në lidhje me vendimmarjen, mbështetur në Kodin e Sjelljes, konsiderohet si detyrues vendimi i marrë aty për aty nga drejtuesi i seancës, pa qenë nevoja për ndërprerje, nëse drejtuesi i seancës nuk e konsideron të nevojshme. Nëse gjykohet nga drejtuesi i seancës, ai mund të vendosë një afat pushimi, pas të cilit deklarohet vendimi i marrë dhe më tej, nëse ka ankesa, zbatohen procedurat dhe afatet e shqyrtimit nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Çdo deputet mund t'i kërkojë me shkrim Këshillit për Rregulloren dhe Imunitetin, interpretim për zbatimin e dispozitës/dispozitave të caktuara që përfshihen në kreun e Rregulores së Kuvendit që parashikon dispozitat e Kodit të Sjelljes, pavarësisht nëse ka ose jo ndonjë procedurë të nisur e që preket ose reflekton zbatimin e dispozitës/dispozitave. Interpretimi i Këshillit për Rregulloren dhe Imunitetin është detyrues në zbatimin dhe trajtimin e çështjes në të ardhmen nga Byroja e Kuvendit.

Byroja e Kuvendit si autoritet përgjegjës

Byroja e Kuvendit, si autoriteti përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes, është organi që në shkallë të fundit merr në shqyrtim rastet dhe vendos për masat për shkeljen e normave të sjelljes.

Masat disiplinore që zbatohen në raste të shkeljeve janë ato të parashikuara në nenin 63 të Rregullores së Kuvendit. Të gjitha rastet e shkeljes së Kodit të Sjelljes, që janë shpjeguar në mënyrë të detajuar në këtë udhëzues, për marrjen e masës disiplinore referojnë në kreun “Rregulli dhe sjellja në Kuvend” të Rregullores së Kuvendit, nenet 62 – 67 të saj.

Përveç sa parashikohet shprehimisht në këtë udhëzues, Byroja e Kuvendit, me kërkesë të një deputeti ose grupi parlamentar, si dhe sipas parashikimeve të posaçme për raste të veçanta të përshkruara në këtë udhëzues, merr në shqyrtim edhe çdo rast tjetër që nga kërkesi konsiderohet si sjellje ose veprim në kundërshtim me ndonjë prej dispozitave të Kodit të Sjelljes.

Byroja e Kuvendit, për raste të kërkesave për marrje të masave disiplinore për shkelje të dispozitave të Kodit të Sjelljes, mblihet menjëherë dhe pas shqyrtimit të provave, arsyetimit të kërkesës nga ana e kërkesit dhe dëgjimit të deputetit të prekur nga kërkesa, merr vendim për dhënien ose jo të masës disiplinore.

Në rast të vendimit për dhënien e masës disiplinore, kopje e vendimit i përcillet Shërbimit të Trajtimit të Deputetëve, për t’u referuar në regjistrin e masave disiplinore, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Administrimi dhe përditësimi i regjistrave, formularëve dhe deklaratave

Shërbimi i Trajtimit të Deputetëve është përgjegjës për administrimin e formularëve, deklaratave dhe regjistrave që mbahen dhe përditësohen në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga Kodi i Sjelljes.

Vënia në zbatim për herë të parë i disa dispozitave të Kodit të Sjelljes

Brenda katër muajve nga miratimi i këtij udhëzuesi, njësia e Kuvendit që mbulon Shërbimin e Trajtimit të Deputetëve vë në funksionim të gjithë regjistrat elektronikë që parashikohen nga Kodi i Sjelljes.

Brenda një muaji nga ngritja e regjistrit të masave disiplinore, duhet të përfundojë plotësimi i regjistrit me të dhënat për masat disiplinore të marra gjatë legjislaturës së fundit.

Brenda një muaji nga ngritja e regjistrit të masave disiplinore, duhet të ketë përfunduar administrimi i listës së masave disiplinore të tre legjislaturave të kaluara, për të gjithë ish-deputetët. Këto të dhëna duhet të shërbejnë si të dhëna të gatshme për t’u përfshirë në regjistrin e masave disiplinore, sa herë që një ish-deputet rizgjidhet si i tillë.

Prezantimi i udhëzuesit për deputetët

Ky udhëzues u shpërndahet deputetëve menjëherë pas miratimit dhe shoqërohet me organizimin e takimeve prezantuese të udhëzuesit, për deputetët.